

Kurti kërkon nga ShBA-ja
t'i bëjë trysni Beogradit për
dorëzimin e Radoiçiqit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDON NDIHMA E SHBA-SË PËR KOSOVËN, NËNSHKRUHET MARRËVESHJA
PËR GRANTIN MBI 34 MILIONË DOLLARË

FAQE 4

KOSOVA PËRFITON NGA SHBA-ja MBI 34 MILIONË DOLLARË

- Hovenieri: Po përballemi me disa sfida me qeverinë
e Kurtit që kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nëpërmjet USAID-it kanë ndihmuar Kosovën edhe me mbi 34 milionë dollarë. Marrëveshja është nënshkruar në mes të presidentes së Kosovës, Vjosa

Osmani dhe përfaqësueses së USAID-it, Mary Elieen Devitt. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier ka thënë se përkushtimi i ShBA-së ndaj popullit të Kosovës

është po aq i fortë dhe i hekurt si gjithmonë. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se janë duke u përballur me disa sfida me qeverinë e Kurtit që, sipas tij, kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit ShBA – Kosovë

**ROUGE: NATO
PRET NGA SERBIA
TË SIGUROJË
LLOGARIDHËNIE PËR
SULMET NË ZVEÇAN
DHE BANJSKË**

F. 5



**FUSHATA ZGJEDHORE FILLON
MË 11 JANAR 2025**

F. 5



**QEVERIA NIS PROJEKTIN
20-MILIONËSH PËR ZHVILLIMIN
RURAL DHE AGROTURIZMIN**

F. 8

**NGA 3 SHTATORI PUNËTORËT
TEKNIKË TË QMF-VE, SHKOLLAVE,
QKUK-SË DHE UP-SË HYJNË
NË GREVË NËSE PAGAT
S'U DALIN ME RITJE**

F. 8

RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shagiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Ahmeti, ambasadorit të Francës: Legjitimiteti po shkelet rëndë nga qeveria monoetnike, BDI-ja nuk destabilizon

TETOVË, 21 GUSHT - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka pritur të mërkurën në selinë e partisë në Tetovë ambasadorin e Francës në Maqedoninë e Veriut, Siril Bomgartner. Siç ka njoftuar BDI-ja, bashkëbiseduesit kanë diskutuar rreth zhvillimeve politike në vend dhe rajon, integritetit evropian dhe ndryshimeve kushtetuese sipas frymës së marrëveshjes së Ohrit dhe legjitimitetit.

Ahmeti ka akuzuar qeverinë aktuale për shkeljen e legjitimitetit në raport me shqiptarët. “Kryetari Ahmeti ka përsëritur përkrahjen e madhe të Bashkimit Demokratik për

Integrim për ndryshimet kushtetuese në përputhje me Marrëveshjen e fqinjësisë së mirë për ta përfshirë komunitetin bullgar në kushtetutë me ç’rast zhbllkohet rruga drejt Bashkimit Evropian, gjithashtu ka shprehur nevojën e respektimit të emrit kushtetues dhe të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë. Ahmeti foli për frymën e Marrëveshjes së Ohrit, të garantuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila po shkelet rëndë nga qeveria me legjitimitet monoetnik. Legjitimiteti buron nga zgjedhjet ku shprehet vullneti demokratik i popullit për t’i zgjedhur përfaqësuesit e vet, në veçanti në shoqëri multietnike ku

partitë janë të organizuara në baza etnike. Humbësit e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare nuk janë përfaqësues legjitim të popullit shqiptar, por janë shërbëtorë të OBRM-PDUKM-së dhe po shkatërrojnë çdo të arritur në drejtim të barazisë”, ka njoftuar BDI-ja.

Në lidhje me situatën e sigurisë, siç është thënë në njoftimin e BDI-së, Ahmeti ka alarmuar për mashtrimin e madh qeveritar për të inskenuar skenarë destabilizues që të defokusohet opinioni publik. “BDI nuk është pjesë e asnjë skenari destabilizues dhe hedh poshtë çdo tendencë komplotiste qeveritare”, citohet të ketë thënë Ahmeti.



Blinkeni përmbyll vizitën në Lindjen e Mesme pa marrëveshje armëpushimi në Gazë

DOHA, 21 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka synuar që gjatë vizitës së tij në Lindjen e Mesme të arrihej një marrëveshje armëpushimi në Gaza. Por, kryediplomati amerikan e ka përmbyllur udhëtimin e tij në këtë rajon pa një marrëveshje në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Blinken dhe ndërmjetësit nga Egjipti dhe Katari kanë varur shpresat te një propozim “kompromisi” të prezantuar nga ShBA-ja që synon t’i ngushtojë dallimet mes Izraelit dhe Hamasit në luftën 10-mujore, pasi negociatat përfunduan javën e kaluar pa një marrëveshje. Marrëveshja “duhet të bëhet dhe duhet të arrihet në ditët në vijim. Ne do të bëjmë gjithçka që mundemi që kjo të arrihet”, ka



thënë Blinkeni për gazetarët në Doha të martën, para se të nisej drejt Uashingtonit.

Një zyrtar i lartë i administratës amerikane, që udhëtonte me Blinkenin, ka thënë se ShBA-ja pret që bisedimet për armëpushim të vazhdojnë këtë javë.

Blinkeni ka qëndruar në Egjipt, ku

ka zhvilluar bisedime me presidentin Abdel-Fatah El-Sisi, më pas ka vizituar Katarin. Para vizitës në këto dy shtete, Blinkeni ishte takuar me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu. Pas takimit me të, Blinkeni ka thënë se Izraeli ka pranuar propozimin dhe i ka bërë thirrje edhe Hamasit

që ta pranojë. Grupi radikal palestinez nuk e ka refuzuar propozimin në mënyrë eksplicite, por ka thënë se propozimi i fundit zhbënë kushtet për të cilat palët janë pajtuar paraprakisht.

Blinkeni është pyetur në Katar lidhur me kushtet për tërheqjen e trupave izraelite në bazë të një marrëveshjeje armëpushimi. Ai është pyetur t’i komentojë raportimet se Netanyahu ka thënë se mund ta bindë Blinkenin që Izraeli t’i mbajë trupat në Korridorin Filadelfia midis Egjiptit dhe Gazës.

“ShBA-ja nuk pranon një pushtim afatgjatë të Gazës nga Izraeli. Më specifikisht, marrëveshja është e qartë sa i përket kohës dhe lokacioneve të tërheqjes së forcave izraelite nga Gaza dhe Izraeli është pajtuar për këtë”, ka thënë ai.

Si Hamasi ashtu edhe Egjipti kundërshtojnë idenë që Izraeli të mbajë trupa në Korridorin

Filadelfia, por Netanyahu ka insistuar se trupat janë të nevojshme të qëndrojnë atje, në mënyrë që të ndalet kontrabanda e armëve për në Gaza.

“Armëpushimi në Gazë duhet të jetë nisje e një njohjeje më të gjerë ndërkombëtare e shtetit palestinez dhe e zbatimit të zgjidhjes me dy shtete, pasi kjo është garanci për stabilitetin në rajon”, ka thënë Sisi pas takimit me Blinkenin.

Blinkeni ka thënë se propozimi i fundit për marrëveshjen “ndoshta është më i miri, ndoshta është mundësia e fundit”.

ShBA-ja dhe ndërmjetësit po synojnë të arrijnë marrëveshje për t’i dhënë fund luftës që nisi më 7 tetor, pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Si pasojë e ofensivës izraelite, në Gaza janë vrarë më shumë se 40 mijë persona.

Ukraina ratifikon statutin e Romës, pritet t’i bashkohet Gjykatës Ndërkombëtare Penale

KIEV, 21 GUSHT - Pas disa vitesh hezitimi dhe pavarësisht kundërshtimit nga ushtria, Parlamenti i Ukrainës ka votuar për t’u bashkuar me Gjykatën Penale Ndërkombëtare (ICC) me shpresën për ta ndëshkuar Rusinë për krimet e dyshuara të luftës që ka kryer në Ukrainë. Çështja është veçanërisht e ndjeshme në vend, pasi shumë kanë frikë se ushtarët ukrainas që luftojnë kundër ushtrisë ruse do të jenë në shënjestër të ICC-së, e cila ka për detyrë t’i ndjekë penalisht autorët e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe

krimeve të luftës.

Një total prej 281 deputetësh kanë votuar për ta ratifikuar Statutin e Romës, traktatin themelues të ICC-së.

Ky vendim do të krijojë “shansin më të madh për t’i ndëshkuar rusët dhe do ta forcojë izolimin e Rusisë”, ka thënë deputetja Evgenia Kravchuk e cila i përket partisë së presidentit Volodymyr Zelensky. Sipas saj, Ukraina përmendi nenin 124 të Statutit të Romës, i cili lejon çdo ukrainas civil apo ushtarak të përfshihet nga çdo ndjekje penale nga ICC-ja për krime lufte

për shtatë vjet.

Ratifikimi i statutit është pjesë e angazhimeve të Kievit ndaj BE-së, ka shpjeguar Kravchuk. “Është një masë e nevojshme, plotësisht e justifikuar dhe e sigurt”, ka thënë ajo.

Irina Gerashchenko si dhe partia e saj, opozita Solidariteti Ecropian, kanë votuar kundër propozimit. Gerashchenko madje ka folur për “diskutime të vështira” në parlament para votimit. “Ushtria kërkoi që ratifikimi të bëhet pas heqjes së gjendjes ushtarake”, ka thënë Gerashchenko.



Turqia ndan 1 milion dollarë për FSK-në

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka njoftuar se zyrtarisht ka pranuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Turqisë, e cila ka ndarë për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës 31 milionë lira ose rreth 1 milion dollarë amerikanë donacion për ngritjen e kapaciteteve ushtarake të FSK-së. Maqedonci ka thënë se ky

donacion është pjesë e programit të mbështetjes së jashtme ushtarake të qeverisë turke. “Marrëdhëniet mes dy vendeve tona kanë qenë gjithnjë në nivelet më të larta dhe kontributi i Republikës së Turqisë në ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka qenë i vazhdueshëm si në aspektin e trajnimeve, po ashtu edhe në atë të pajisjeve ushtarake.

Falënderoj Republikën e Turqisë për donacionin dhe siguroj që bashkëpunimi ynë i ndërtuar në frymën e besimit të dyanshëm, do të vazhdojë edhe në vitet në vijim”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”. Në këtë drejtim ai ka thënë se Turqia si shtet mik mbetet një nga partnerët strategjikë më të rëndësishëm për Republikën e Kosovës.



Kurti kërkon nga ShBA-ja t'i bëjë trysni Beogradit për dorëzimin e Radoiçiqit

ÇIKAGO, 21 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është duke marrë pjesë në Konventën Kombëtare Demokratike (DNC), ku Kamala Harris edhe zyrtarisht do të nominohet për presidente të ShBA-së. Në kuadër të kësaj konvente janë duke u mbajtur edhe panele të ndryshme diskutimi të organizuara nga DNC-ja. Kurti ishte pjesë e panelit të diskutimit “Konventa Kombëtare Demokratike dhe Roli i Partive Politike”, ngjarje e cila është duke u zhvilluar në Çikago, Illinois. Para fillimit të diskutimit, kryeministri është takuar dhe ka bashkëbiseduar me kryetarin e Komitetit Kombëtar Demokrat, Jaime Harrison, në prani dhe të presidentes së NDI-së, Tamara Wittes dhe kryetarit të bordit drejtues të NDI-së, Tom Daschle. Pjesë e panelit bashkë me udhëheqësin e Qeverisë së Kosovës ishin dhe ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, lord George Robertson dhe ministri i

Jashtëm i Danimarkës dhe ish-kryeministri Lars Lokke Rasmussen. Në temën e diskutimit për rolin e partive dhe mënyrat se si ato duhet të përgatiten për t'iu bërë ballë sfidave, Kurti ka thënë se partitë politike natyrshëm janë politike dhe që çështja është t'i kthejmë ato në shoqërore. “Partitë politike janë natyrshëm politike. Sfidat janë se si t'i kthejmë në shoqërore. Këtu mendoj se qëndron sukcesi ynë. Tri kategoritë shoqërore që e mundësuan fitoren tonë janë gratë, të rinjtë dhe diaspora. Filluam duke vënë në pah kontributin e grave në shoqëri dhe duke nënvizuar rolin shoqëror të grave. Në anën tjetër, duke pasur moshën mesatare të popullsisë në Kosovë 34 vjeç, punuam me të rinjtë përmes kulturës, artit, sportit e debateve mbi teoritë kritike”, ka thënë Kurti. Kryeministri Kurti është takuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) edhe me senatorin Chris Murphy. Së pari,



duke theksuar marrëdhëniet e fuqishme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kryeministri Kurti ka shprehur interesimin e tij për rritjen e bashkëpunimit e shkëmbimit tregtar dhe ekonomik me aleatët e partnerët tanë amerikanë. Më tutje, ata kanë biseduar edhe rreth zhvillimeve në vend, situatën e sigurisë në rajon dhe rëndësinë e bashkëpunimit mes shteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe momentin e rëndësishëm në politikën amerikane në kuadër të

zgjedhjeve të ardhshme të 5 nëntorit. Në lidhje me dialogun me Serbinë, kryeministri Kurti ka theksuar përkushtimin e Kosovës në zbatimin në plotni të marrëveshjes bazike dhe aneksit implementues të Ohrit. Ai ka theksuar se për t'u zbatuar marrëveshja, nevojitet pranimi i saj edhe nga ana e Serbisë, duke e nënshkruar atë si dëshmi e garanci të angazhimit në zbatimin e marrëveshjes. Kryeministri Kurti ka nënvizuar se Serbia duhet ta tërheqë letrën

e dërguar drejt Bashkimit Evropian nga ana e ish-kryeministres Ana Brnabić, dhjetorin e vitit të kaluar, përmes së cilës është shprehur refuzimi dhe tërheqja nga marrëveshja nga ana e Serbisë. Kurti ka kërkuar nga ShBA-ja t'i bëjë trysni Beogradit për dorëzimin e kriminelit Millan Radojčić. “Serbia duhet të kthehet te marrëveshja dhe ta respektojë atë në mënyrë që e njëjta të zbatohet. Nuk ka zbatim të marrëveshjes sepse, para së gjithash, nuk po ka respektim të saj. Tash kur po bëhen 11 muaj të vrasjes së rreshterit tonë policor Afrim Bunjaku në Banjskë të Zvečanit, është koha e fundit që kryekrimineli Millan Radojčić t'u dorëzohet autoriteteve të drejtësisë së Kosovës”, citohet të këtë thënë Kurti. Kryeministri Kurti e ka falënderuar senatorin Murphy për takimin dhe bisedën, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të tij ndaj Kosovës.

Kastrati: Vizita e shefit të CIA-s në rajon synon t'i ndalë përpjekjet e Rusisë për një konflikt të mundshëm

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se vizita në rajon e shefit të Agjencisë Qendrore amerikane të Inteligjencës (CIA), William Burns, ka treguar se Shtetet e Bashkuara kanë informacione të mjaftueshme për përpjekjet e Rusisë – përmes aleates së

saj, Serbisë, që Ballkani Perëndimor të jetë në rrezik për një konflikt të mundshëm. Ai pret që Burns të japë rekomandime të “fuqishme” edhe për institucionet e Kosovës lidhur me pjesën veriore, që të mos ndërmarrin veprime pa u koordinuar me NATO-n, ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, në mënyrë që të mos krijohet një



situatë e pamenaxhueshme. Kastrati ka theksuar se mesazhet kryesore Burnsi do t'i përcjellë në Beograd pasi, sipas tij, aty gjendet qendra e lëvizjeve radikale drejt Bosnjës dhe Kosovës. Më tutje, Kastrati ka thënë se pret që politika në Bosnjë-Hercegovinë ta bllokojë dhe të eliminojë ndikimin e liderit të Republikës Sërpska, Millorad

Dodik. “Vizita e shefit të CIA-s në këtë hapësirë lë të kuptohet se ata kanë informacione të bollshme për përpjekjet e Rusisë nëpërmjet satelitit të saj - Serbisë - se kjo pjesë e Evropës është një rrezik për një konflikt të mundshëm dhe sigurisht për atë arsye ka ardhur këtu për t'i dhënë rekomandimet e veta”, ka thënë Kastrati.

Rouge: NATO pret nga Serbia të sigurojë llogaridhënie për sulmet në Zvečan dhe Banjskë

Beograd, 21 gusht - Ndihmësekretari i përgjithshëm i NATO-s për çështje të jashtme dhe siguri, Boris Rouge dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar në Beograd. Rouge ka thënë se NATO pret nga Serbia të ndihmojë të sigurohet

llogaridhënie e plotë për sulmet e majit dhe shtatorit të vitit të kaluar. “Një bashkëbisedim i mirë me presidentin Aleksandër Vuçiq për marrëdhëniet NATO - Serbi që shpresojmë t'i shohim të thellohen. Po ashtu, kemi diskutuar për çështjet rajonale,

përfshirë sigurinë e qëndrueshme në Kosovë. NATO po sheh nga Serbia që të ndihmojë të sigurojë llogaridhënie të plotë për aktet e dhunshme të majit dhe shtatorit të vitit 2023”, ka shkruar Ruge në platformën “X”.





VAZHDON NDIHMA E SHBA-SË PËR KOSOVËN, NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR GRANTIN MBI 34 MILIONË DOLLARË

Kosova përfiton nga ShBA-ja mbi 34 milionë dollarë

- Hovenieri: Po përballemi me disa sfida me qeverinë e Kurtit që kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nëpërmjet USAID-it kanë ndihmuar Kosovën edhe me mbi 34 milionë dollarë. Marrëveshja është nënshkruar në mes të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani dhe përfaqësueses së USAID-it, Mary Elieen Devitt. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier ka thënë se përkushtimi i ShBA-së ndaj popullit të Kosovës është po aq i fortë dhe i hekurt si gjithmonë. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se janë duke u përballur me disa sfida me qeverinë e Kurtit që, sipas tij, kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit ShBA - Kosovë

Kosovës, Jeffrey Hovenier. Ndërsa ambasadori Hovenier ka thënë se ndihma e tillë për Kosovën nga qeveria amerikane ka nisur 25 vjet më parë dhe deri më tani, Uashingtoni ka ofruar mbi 1 miliard dollarë për ta mbështetur popullin e Kosovës. “Ngjarja e sotme, përmbyllja e marrëveshjes prej 34.5 milionë dollarësh si mbështetje shtesë për popullin e Kosovës, për rritje ekonomike, integrimin evropian, mendoj se qartësisht thekson këtë qëndrim. Megjithatë, duhet ta pranoj se ky angazhim ndaj popullit të Kosovës jo domosdo vlen për ndonjë qeveri të veçantë apo për zgjedhjet e politikave apo veprime të asaj qeverie”, ka thënë Hovenieri. Ai ka thënë se me këto fonde është ndihmuar qeverisja lokale dhe qendrore, zhvillimi ekonomik, forcimi i sektorit të energjisë, i medieve të pavarura dhe fusha të tjera në Kosovë. “Këto fonde të reja ngjashëm do të shkojnë në forcimin e ekonomisë së Kosovës dhe ta mbështesin qeverisjen e mirë dhe shërbime më efektive nga qeveria për të gjithë qytetarët nga Kosova.

Mendojmë se kjo do ta ndihmojë Kosovën që të integrohet më shumë në tregun evropian dhe ta afrojë shtetin me institucionet euroatlantike, sikurse BE-ja, që sigurisht është qëllim që e ndajmë të gjithë”, ka thënë Hovenieri.

Hovenieri: Po përballemi me disa sfida me qeverinë e Kurtit që kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit

Gjatë kësaj konference ambasadori amerikan Jeffrey Hovenieri ka folur për cilësinë e partneritetit në mes të ShBA-së dhe Qeverisë së Kosovës të udhëhequr nga Albin Kurti. Ai ka përsëritur deklaratat e tij të mëhershme se Uashingtoni zyrtar është duke u përballur me disa sfida nga Qeveria e Kosovës. Ai ka thënë se këto sfida kanë ndikuar në partneritetin e Kosovës me Amerikën. Më tutje, Hovenieri ka thënë se shpreson që Qeveria e Kosovës do t'i kthehet angazhimit të ngushtë

dhe konstruktiv me ShBA-në, BE-në e NATO-n. “Shumë prej jush keni parë raporte në medie për dallimet e tashme ndërmjet ShBA-së dhe anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare me Qeverinë e Kosovës për disa veprime, të cilat janë të udhëhequra me qeverinë e kryeministrit Kurti. Siç kam thënë edhe javën e kaluar, po përballemi me disa sfida me qeverinë e tanishme, të cilat kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit tonë. Është, siç tha zëdhënësi i Departamentit të Shtetit më herët gjatë këtij muaji, qeveria amerikane shpreson që Qeveria e Kosovës, po e citoj, ‘do t’i kthehet angazhimit të ngushtë dhe konstruktiv me ShBA-në, BE-në, NATO-n dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë’”, ka thënë Hovenieri. Megjithatë, Hovenieri ka vlerësuar se përkushtimi i ShBA-së ndaj popullit të Kosovës është po aq i fortë dhe i hekurt si gjithmonë. “Edhe pse disa fusha të bashkëpunimit me qeverinë e tanishme mbeten më pak pozitive sesa do të kishim shpresuar, përkushtimi i ShBA-së

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 21 GUSHT - Republika e Kosovës dhe Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen për grantin, që ofron ndihmë shtesë për institucionet e Kosovës në vlerë prej 34.5 milionë dollarësh. Fondet shtesë prej 34.5 milionë dollarësh janë pjesë e marrëveshjes së arritur më herët, që arrin vlerën prej 146.2 milionë dollarësh e që, sipas presidentes

së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila e ka nënshkruar grantin në emër të Kosovës, synon të ofrojë shërbime më të mira për qytetarët, ta rrisë llogaridhënien e institucioneve dhe të mundësojë qeverisje efektive. “Marrëveshja që sapo nënshkruam me ShBA-në, me USAID-in, është edhe një rikonfirmim drejt vizionit tonë të përbashkët, drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë qytetarët tanë”, ka thënë Osmani gjatë një konference për medie me ambasadorin amerikan në

Peci: Veprimi i njëanshëm i qeverisë për urën mund ta sjellë ndërprerjen e kontratës për raketat ‘Javelin’



PRISHTINË, 21 GUSHT - Drejtori i KIPRED-it, Lulzim Peci, ka ftuar institucionet e Kosovës të jenë të kujdesshme me hapjen e urës së Ibrit. Ai ka vlerësuar se veprimet e

njëanshme të qeverisë për këtë çështje mund ta çojnë Kosovën në një përplasje të re me Perëndimin. Kjo përplasje, sipas tij, do t'i sillte pasoja të rënda Kosovës. Peci ka

paralajmëruar pasoja të mëdha për Kosovën nëse qeveria Kurti nuk i dëgjon këshillat e ShBA-së dhe BE-së për veriu. Ai ka bërë me dije se veprimi i njëanshme

për hapjen e urës së Ibrit mund t'i sjellë Kosovës pasoja në aspektin ekonomik dhe atë të sigurisë. Në fushën e sigurisë, ka thënë ai, mund të preket ndihma e ShBA-së

për FSK-në. Peci ka vlerësuar se këtu mund të përfshihet edhe ndërprerja e kontratës për raketat “Javelin”. “Pasojat mund të jenë ekonomike (sanksione dhe masa të tjera politike), ashtu edhe në fushën e sigurisë, që mund të shkojnë deri te ndërprerja e ndihmës ndaj FSK-së, përfshirë këtu edhe ndërprerjen e kontratës për raketat Javelin nga ana e ShBA-së. Sot Kosovën nuk e përkrahin në fushën ndërkombëtare edhe miqtë më të mëdhenj të saj. Ky është treguesi më i mirë i situatës në të cilën jemi tani, për të cilën do të duhet shumë kohë që të rikuperohet”, ka thënë ai për “Nacionalen”. Nder të tjera, ai i ka kritikuar ashpër sulmet e eksponentët e pushtetit ndaj KFOR-it. Pretendimet e njerëzve të tillë për ta paraqitur KFOR-in si dorë të zgjatur të qëndrimeve të Serbisë, sipas tij, janë absurde dhe tejet të dëmshme për Kosovën. Peci është shprehur i bindur se përplasia e Policisë së Kosovës me trupat e NATO-së për çështjen e hapjes së urës nuk do të ndodhë. Ai ka bërë me dije se kjo do të ishte vetëvrasëse për Republikën e Kosovës.

ndaj popullit të Kosovës është po aq i fortë e i hekurt si gjithmonë”, ka thënë ambasadori Hovenier. Kujtojmë se ShBA-ja, por edhe shtete të tjera të Quintit (Mbretëria e Bashkuar, Franca, Italia dhe Gjermania) si dhe Bashkimi Evropian kanë kritikuar disa veprime të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës në veri. Bashkësia ndërkombëtare e ka cilësuar si veprim të pakoordinuar dhe të njëanshëm mbylljen e disa zyrave të Postës së Serbisë në veri të Kosovës në fillim të gushtit, ndërkaj ShBA-ja dhe Quinti kanë thënë se nuk duhet tani që autoritetet e Kosovës ta hapin për qarkullim të automjeteve urën kryesore mbi lumin Ibër. Qeveria e Kurtit ka thënë se po vazhdon konsultimet dhe koordinimet me bashkësinë ndërkombëtare për hapjen e urës, që ndan Mitrovicën e Jugut me shumicë shqiptare dhe atë të veriut me shumicë serbe.



Haliti: Ndërkombëtarët janë të përgatitur që në momentin kur të hapet ura e Ibrit, ta mbyllin



PRISHTINË, 21 GUSHT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Xhavit Haliti, ka deklaruar se në bazë të informatave që ai ka, ura mbi lumin Ibër, pasi të jetë hapur nga Qeveria e Kosovës, do të mbyllet nga KFOR-i dhe ndërkombëtarët. Në kuadër të kësaj, Haliti ka thënë se Kosova nuk duhet të vihet në atë pozitë. “Nga të dhënat e mia që i kam dhe

besoj që asnjëherë nuk më kanë dalë ndryshe, KFOR-i dhe ndërkombëtarët janë të përgatitur që në momentin që të hapet ura, ta mbyllin ata. Tani kush është i zoti të luftojë me të le ta hapë. Nuk është mirë ta sjellin veten në pozitë të tillë”, ka thënë Haliti për “Tëvë1”. Më tutje, Haliti ka deklaruar se çështjet e brendshme të Mitrovicës duhet të diskutohen

me serbët lokalë dhe jo me Beogradin. “E mira e së mirës është të bisedojmë me serbët në veri se ata janë pengesa kryesore. Problemi duhet të kalojë në Mitrovicë e jo të flitet me Beogradin për Mitrovicën, se Mitrovica është e jona. Por, meqenëse po diskutohet për shumë çështje të Kosovës në Bruksel, edhe pse diskutohet për modalitetet e hapjes nuk prish punë”, ka thënë Haliti.


Tre të vdekur dhe mbi 600 raste me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 21 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në dy javët e fundit janë raportuar 661 raste aktive me Covid-19 dhe tri raste të vdekjes.

IKShPK-ja ka thënë se vaksinimi është mënyra e vetme efikase e mbrojtjes kundrejt infektimit. “Situata

epidemiologjike në Kosovë në dy javët e fundit. Në dy javët e fundit (07.08.2024 – 20.08.2024) janë raportuar 661 raste pozitive dhe tre (3) raste të vdekjes me Covid-19. Nga 661 rastet e raportuara gjatë kësaj periudhe kohore, rezulton se grup-mosha më e prekur janë: 50-59 vjeç me 119 raste dhe grup-mosha 20-29 vjeç me 116

raste, me moshë mesatare prej 49.3 vjeç; Vaksinimi vazhdon të jetë masa mbrojtëse me efikase kundër Covid-19 dhe gripit, veçanërisht ndaj formave të rënda të sëmundjes. Mbrojtja përmes vaksinës e individëve në rrezik të lartë të rezultateve të rënda (si p.sh. të moshuarit) mbetet i rëndësishëm”, ka njoftuar IKShPK-ja.



Përkujtohet Bajram Rexhepi

PRISHTINË, 21 GUSHT - Të mërkurën janë bërë shtatë vjet që kur është ndarë nga jeta ish-kryeministri i parë i Kosovës në kohën e pasluftës, Bajram Rexhepi. Ai është kujtuar nga kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi dhe kandidati i kësaj partie për kryeministër, Bedri Hamza.

Krasniqi ka thënë se Rexhepi gjatë gjithë jetës së tij ka qenë në shërbim të qytetarëve dhe atdheut. “Në 7-vjetorin e kalimit në amshim, nderojmë dhe kujtojmë kryeministrin e politikanin e shquar, doktorin e përkushtuar, njeriun e mirë e të dashur, mikun tim Bajram Rexhepi. Dr. Bajrami tërë jetën u angazhua për t’i shërbyer qytetarëve dhe atdheut. I përgjegjshëm dhe parimor, i përkushtuar dhe i vendosur - i tillë ishte gjithmonë. Përherë në zemrat tona!”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Ndërsa Bedri Hamza ka thënë se Kosova dhe Mitrovica 7 vjet më parë kanë mbetur pa njeriun e popullit dhe mjekun e luftës. “Kosova dhe Mitrovica, 7 vjet më parë, mbetën pa njeriun e

popullit, mjekun e luftës, kryeministrin e parë të pasluftës, Bajram Rexhepin. Sot, në përvjetorin e shkuarjes së tij në amshim, e kujtojmë si figurë unifikuese të politikës në Kosovë. Ai ishte i pandalshëm në angazhimin e tij me dekada të tëra për fuqizimin e shtetit tonë. Si mjek e humanist, si kryeministër e ministër i Qeverisë së Kosovës, si kryetar e qytetar i Mitrovicës, si mik e bashkëpunëtor, Bajram Rexhepi ishte gjithnjë i dëshmuar”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.

Bajram Rexhepi ka lindur në Mitrovicë më 3 qershor 1954. Studimet pasuniversitare i kishte kryer në Zagreb në vitin 1985. Ka punuar kirurg i përgjithshëm dhe specialist endoskopik në Spitalin Rajonal të Mitrovicës deri në vitin 1990. Gjatë luftës së Kosovës më 1999, Rexhepi ishte bashkuar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ku kishte kontribuar si mjek. Përpos ushtrimit të funksionit të mjekut dhe kryeministrit, Rexhepi ka shërbyer edhe kryetar i Mitrovicës dhe ministër i Punëve të Brendshme.



MKRS-ja paditë komunën e Prizrenit për rrënimin e “Kompleksit Saraji i Vjetër”

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se kanë dorëzuar kallëzim penal ndaj komunës së Prizrenit për rrënimin e monumentit në mbrojtje të përhershme “Kompleksi Saraji i Vjetër”. Në një konferencë për medie, Çeku ka thënë se ky veprim i autoriteteve komunale është i dënueshëm dhe se kompleksi është rrënuar dy muaj para se t’i kthehet shtetit kjo pronë. “Arsyeja e kësaj konference është informimi publik i një rrënimi të qëllimshëm të monumentit në mbrojtje të përhershme ‘Kompleksi Saraji i Vjetër’. Sot në Prokurorinë Themelore në Prizren kemi dorëzuar kallëzim penal ndaj kryetarit të Prizrenit, drejtorit për



Investime Kapitale në këtë qytet. Kodi penal i dënon deri në 10 vjet dënim dhe me gjobë nga një mijë deri në dy mijë euro. Kompleksi u rrënuar dy muaj para se të kthehet në pronë të shtetit, të cilët

konsiderojmë që kanë bërë shkelje flagrante. Veprimi i rrënimin është realizuar me dy leje të kësaj komune: leja për rrënim dhe për ndërtim. Të dyja janë në kundërshtim me ligjin dhe

Kushtetutën e Kosovës”, ka thënë Çeku.

Sipas tij, e vetmja punë që mund të bëhet në monumente të tilla është renovimi dhe se këtë mund ta bëjë vetëm Ministria e Kulturës. Me të marrë informata, Çeku ka thënë se ka njoftuar organet e rendit të cilat kanë ndaluar rrënimin, ndonëse e sheh të vonuar pasi intervenimi i saj është i pamundur për shkak të dëmeve të mëdha.

“Sipas ligjit, lejohen vetëm renovimet, andaj Ministria e Kulturës është i vetmi organ kompetent i cili mund të ndërhyjë në monumente. Menjëherë pas marrjes së informatës së rastit, inspektorët e kanë konstatuar fillimin e rrënimin dhe janë ndaluar punimet. Policia e Kosovës ndalon

punimet, rrënimet e punimeve tashmë kanë ndodhur dhe intervenimi i saj tashmë është i pamundur. E kemi kundërshtuar vendimin e komunës. Jemi detyruar të merremi me hapin e radhës dhe në bazë të ligjit ruajtja e trashëgimisë kulturore ‘Kompleksi Sarajë e Vjetër’, shquhet si aset me vlera historike. Pas vlerësimit të dëmit të shkaktuar qëllimshëm kemi bërë vlerësim dhe ndërtesat e ish-fabrikës janë rrënuar nëpërmjet mjeteve makinerike që kanë shkaktuar dëm rreth 90 për qind. Kërkojmë rikthimin e asetit në gjendjen e mëhershme. Për rastin e dëmtimit të trashëgimisë kulturore kemi mbajtur takime dhe kemi themeluar mbrojtje të këtyre monumenteve”, ka thënë Çeku.

Fillon pastrimi i shtretërve të lumenjve të Kosovës

Prishtinë, 21 gusht - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar se ka filluar puna për pastrimin e shtretërve të lumenjve të Kosovës. Aliu ka treguar se

cilët lumenj do të pastrohen fillimisht. “Bashkë jemi rojtarë të tokës, ujit dhe vendit ku jetojmë, e lufta ndaj mbetjeve do të vazhdojë përditë, sigurisht

me institucione përgjegjëse, projekte konkrete, por edhe me qytetarë vullnetarë të shumtë që e duan një Kosovë sa më të pastër”, ka njoftuar ministri Aliu.



Fushata zgjedhore fillon më 11 janar 2025

PRISHTINË, 21 GUSHT - Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë miratuar të mërkurën rregulloren për zgjedhje të parakohshme dhe të jashtëzakonshme. Arianit Elshani nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka lexuar afatet kryesore ku ka thënë se fushata zgjedhore për

zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit do të fillojë më 11 janar të vitit 2025. "Deklarimi i partive politike për formimin e koalicioneve zgjedhore ka një afat prej 16 gushtit deri më 30 gusht. Aplikimi për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve fillon më 1 shtator dhe përfundon më 11 dhjetor 2024. Tërheqja e shortit për

renditjen e subjekteve politike në fletëvotim do të bëhet më 7 janar. Periudha e fushatës zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje fillon më 11 janar dhe përfundon në ditën e zgjedhjeve, para hapjes së vendvotimeve. Zbatimi i periudhës së shërbimit të votuesve për ndërrimin e

qendrës së votimit brenda komunës për qytetarët fillon nga 29 gushti dhe përfundon më 26 dhjetor. Periudha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës fillon nga 29 gushti dhe përfundon më 26 dhjetor. Afati për dërgimin e fletëvotimeve përmes postës dhe në kutinë postare të shtetit ku është regjistruar votuesi apo në



shtetin më të afërt ku është hapur kutia postare fillon më 9 janar dhe përfundon më 8 shkurt", ka thënë Elshani.

KQZ-ja vendos: Partitë politike kanë të drejtë t'i shpenzojnë mbi 2 milionë euro për fushatë

PRISHTINË, 21 GUSHT - Një subjekt politik do të ketë të drejtë t'i shpenzojë deri në 2 milionë e 47 mijë e 149 euro për fushatën e zgjedhjeve të 9 shkurtit. Ky vendim është marrë të mërkurën nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Drejtori i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, Besnik Buzhala, ka thënë se vendimi është mbështetur në Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024 2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e votuesve, sipas së cilës, në vendin tonë janë 2 milionë e 47 mijë e 149 votues. "Në vazhdim të mbledhjes, KQZ-ja mori

vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike të cilat do të certifikohen për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Sipas vendimit të KQZ-së, një subjekt politik ka të drejtë të shpenzojë deri në 2 047 149 euro, pra jo më pak se një (1) euro për votues të regjistruar. Kjo llogaritje është bërë duke u mbështetur në Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024 2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve si dhe duke u mbështetur në të dhënat e listës preliminare të votuesve, sipas së cilës, numri i votuesve



në vendin tonë është 2,047,149 votues", ka thënë Buzhala. Po ashtu, KQZ-ja ka vendosur për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kundërshtimeve administrative të parashtruara kundër njoftimit për regjistrim të votueseve jashtë Kosovës. Sipas Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, çdo aplikues, të cilit i është refuzuar regjistrimi, ka të drejtë në kundërshtim administrativ ndaj njoftimit brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Zgjedhjet e rregullta parlamentare janë caktuar të mbahen më 9 shkurt të vitit të ardhshëm.

Haxhiu për përmbaruesit privatë: Qytetarët që konsiderojnë se ka padrejtësi, të parashtrojnë ankesë



PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se miratimi i standardeve profesionale për përmbaruesit privatë shënon një hap të rëndësishëm. Haxhiu është shprehur se ministria që drejton do të angazhohet për të siguruar që qytetarët dhe bizneset në Kosovë të kenë qasje në shërbime përmbare të cilësisë më të lartë. "Miratimi i standardeve profesionale për përmbaruesit privatë shënon një hap të rëndësishëm. Ky është profesioni i parë i lirë ligjor që përfiton nga standarde moderne të zhvilluara me kujdes, të cilat synojnë të vendosin një precedent pozitiv për të gjitha profesionet e tjera ligjore

në vendin tonë. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me prioritetet e saj strategjike, angazhohet për të siguruar që qytetarët dhe bizneset në Kosovë të kenë qasje në shërbime përmbare të cilësisë më të lartë. Zhvillimi dhe zbatimi i këtyre standardeve profesionale jo vetëm që avancojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara, por fuqizojnë mbrojtjen e interesit publik, siguron transparencë në veprimet përmbare dhe garanton një nivel të lartë profesionalizmi në këtë fushë", ka shkruar Haxhiu në "Facebook". Më tutje, ministria Haxhiu i ka ftuar qytetarët që konsiderojnë se ndaj tyre janë bërë padrejtësi, të ushtrojnë ankesë. "Këto standarde

janë rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë mes Ministrisë së Drejtësisë, Odës së Përmbaruesve Privatë dhe Programit për Drejtësi Komerciale të USAID-it, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm në drejtësi të përmirësimit të sistemit tonë të drejtësisë. Të gjithë qytetarët të cilët konsiderojnë që ndaj tyre janë zhvilluar procese të padrejta, i ftoj që të ushtrojnë të drejtën e tyre dhe të paraqesin ankesa pranë Ministrisë së Drejtësisë. Angazhimi i tyre vetëm sa do të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë në Kosovë, dhe funksionimit të këtij sistemi me nivelin më të lartë të përgjegjësisë", ka shkruar Haxhiu.

Haradinaj: Heronjtë e Llapit kanë hise të madhe në lirinë e Kosovës

Podujevë, 21 gusht - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar të mërkurën Podujevën. Ai ka bërë homazhe pranë lapidarëve të të rënëve për lirinë e Kosovës dhe ka zhvilluar një bashkëbisedim me qytetarët dhe veteranët e luftës së UÇK-së. Me këtë rast, Haradinaj ka vlerësuar lart kontributin e heronjve dhe dëshmorëve llapjanë në luftën për liri. Ai ka

thënë se vargu i tyre është i gjatë dhe ka pasur rol të rëndësishëm në çlirimin e vendit. "Heronjtë e Llapit kanë hise të madhe në lirinë e Kosovës. I gjatë është vargoji i heronjve e dëshmorëve llapjanë që i kanë dhënë vlerë kësaj nahije e krejt Kosovës. Që nga Adem Demaçi, disidenti më i madh i historisë së re të Kosovës, Zahir Pajaziti, Ilir Konushevi, Edmond Hoxha, Ali Ajeti e shumë të tjerë, që

tashmë janë ngritur në altarin e lavdisë shqiptare, e llapjanët i kanë derdhur në bronz. Nderimi e përkulja para lapidarëve të tyre të le pa frymë e të jep forcë që Kosovën ta bëjmë ashtu siç ata e kishin ëndërruar, të lirë, të pavarur e të panënshtueshme. Kujtimin për këto kohë lavdie e filluam në një bashkëbisedim me luftëtarë e familjarë të dëshmorëve", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Rritet fitimi i bankave komerciale, 90.9 milionë euro në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti

PRISHTINË, 21 GUSHT - Bankat komerciale në Kosovë vazhdojnë t'i rrisin fitimet e tyre vit pas viti. Ky sektor financiar ka arritur të ketë profit të lartë gjatë periudhës janar-qershor 2024. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për gjashtë muaj të këtij viti nga kreditë bankare dhe shërbimet e tjera ndaj qytetarëve dhe bizneseve bankat komerciale kanë pasur fitim të pastër 90.9 milionë euro ose 8.2 milionë

euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në gjashtëmuajorin e parë 2023 fitimi i bankave ka qenë 82.6 milionë euro. Në vitin 2022 në këtë periudhë profiti i bankave ishte 65 milionë euro. Norma e interesit për muajin qershor të këtij viti ishte 6.1 për qind. Numri i qytetarëve që kanë marrë kredi nëpër bankat komerciale në Kosovë është rritur mbi 6 mijë deri në qershor

të vitit 2024, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Afro 87 mijë qytetarë u janë drejtuar bankave të Kosovës për kredi në gjashtëmuajorin e parë. Ndërsa shuma e përgjithshme e kredive në sektorin bankar deri në muajin qershor është mbi 5 miliardë euro, që nga njohësit e ekonomisë vlerësohet si shqetësuese. Derisa norma mesatare e interesit ka shënuar një rënie të lehtë.



Nga 3 shtatori punëtorët teknikë të QMF-ve, shkollave, QKUK-së dhe UP-së hyjnë në grevë nëse pagat s'u dalin me rritje

PRISHTINË, 21 GUSHT - Nga 3 shtatori të gjithë punëtorët e Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF), punëtorët e shkollave të mesme dhe fillore, ata të sigurimit në QKUK, punëtorët e Kuvendit të Kosovës dhe ata të Universitetit të Prishtinës do të hyjnë në grevë nëse nuk i marrin pagat me rritje. Ky vendim është marrë të mërkurën në takimin e Shoqatës Sindikale të QMF-ve, shkollave, QKUK-së dhe UP-së. Kryesindikalisti i punëtorëve të sektorit privat, Jusuf Azemi, ka thënë se do të hyjnë në grevë nëse pagat s'u dalin me rritje. "Në takimin e mbajtur me punëtorët e disa shoqatave me probleme më të theksuara është marrë vendim që më 3 shtator, të gjithë punëtorët e Qendrave të Mjekësisë Familjare, punëtorët e

shkollave të mesme dhe fillore, punëtorët e sigurimit në QKUK, punëtorët e Kuvendit të Kosovës dhe ata të Universitetit të Prishtinës të hyjnë në grevë. Me përjashtim, greva e punëtorëve të Kuvendit do të fillojë më 16 shtator. Për punëtorët e UP-së data do të caktohet", ka thënë Azemi, duke kërkuar që paga për këta punëtorë të jetë mbi 400 euro. "Të gjithë këta punëtorë janë të gatshëm që të hyjnë në grevë që ditën e nesërme. Sipas ligjit, e kemi lënë edhe një hapësirë nëse partnerët tanë duan të dialogojnë. Komuna e Prishtinës në bazë të tenderit e ka respektuar atë që ne e kemi kërkuar, pagë 405 euro, por nuk e ka respektuar afatin ligjor sepse pagat tona është dashur të rriten", ka thënë Azemi.



Qeveria nis projektin 20-milionësh për zhvillimin rural dhe agroturizmin

PRISHTINË, 21 GUSHT - Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka njoftuar nisjen e një projekti madhor në vlerë 20 milionë euro, i cili ka për qëllim mbështetje për zhvillimin rural dhe agroturizmin. Ky projekt, i mbështetur nga GIZ-i gjerman në kuadër të marrëveshjes ndërkombëtare me qeverinë gjermane, synon ta stimulojë zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e standardit të jetesës për të gjithë qytetarët, pa



dallim gjinie, etnie apo prejardhjeje. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka theksuar se ky projekt përbën një mundësi të shkëlqyer për komunitetet rurale, duke filluar nga komunat veriore. "Me këtë nismë ne synojmë t'i fuqizojmë fermerët tanë dhe ta promovojmë agroturizmin si një shtyllë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik. Inkurajoj të gjithë qytetarët të marrin pjesë në sesionet informuese që do të organizohen në javët në vijim për të përfutur sa më

shumë nga ky projekt", ka thënë Peci. Projekti do të përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve informuese dhe trajnuese për të gjithë të interesuarit, me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe udhëzimeve për aplikim në programet e financimit. Ministria e Bujqësisë dhe Qeveria e Kosovës janë të përkushtuara për të ofruar shërbim të plotë për qytetarët dhe për të ndërtuar së bashku një të ardhme më të mirë për Kosovën. Projekti pritet të fillojë në muajin shtator të këtij viti.

Thirrja për aplikim për subvencionim të pajisjeve eficiente pritet të hapet në shtator

Prishtinë, 21 gusht - Me afrimin e muajve të ftoftë, shumë qytetarë po presin për hapjen e thirrjes së subvencioneve për pompa termike nga Qeveria e Kosovës. Në lidhje me këtë, "Telegrafi" ka kontaktuar Ministrinë e

Ekonomisë, derisa këta të fundit kanë njoftuar se thirrja për subvencione do të hapet në muajin shtator. "Thirrja do të hapet në shtator, por nuk dihet data", kanë thënë shkurt nga Ministria e Ekonomisë. Të pyetur se çfarë subvencione

mund të ketë, nga Ministria e Ekonomisë kanë thënë se nuk janë në dijeni sepse, sipas tyre, mund të ketë ndryshime thirrja. Vitin e kaluar Qeveria e Kosovës ka shpallur hapjen e aplikimit për subvencionimin e pajisjeve eficiente për ngrohje,

specifikisht pompave termike, të cilat janë pajisje elektrike të ngrohjes dhe ftohjes. Vlen të theksohet se vitin e kaluar subvencionimi ka mbuluar 30 për qind të vlerës së investimit të një pompe termike standarde.



George F. KENAN: Memoare 1925-1950 (5)

Bashkimi Sovjetik pretendon t'i zgjerojë kufijtë e ndikimit dhe të fuqisë së vet

Rusët synonin të vendosnin autarki të plotë në shtetet të cilat i kishin pushtuar pas Luftës së Dytë Botërore. Kominterni funksionon fshehurazi.

Moska nuk ka besim në OKB-në



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

III. Shprehja, manifestimi i koncepteve, opinioneve sovjetike në praktikën e politikës zyrtare

Tani e kemi parë natyrën dhe bazat e programit politik sovjetik. Çfarë mund të presim nga ndryshimi i tij në praktikë? Politika sovjetike realizohet, zbatohet në dy plane: 1) në planin zyrtar, i cili përfshinë aksionet e ndërmarrja në emër të qeverisë sovjetike, dhe 2) në planin e fshehtë aksionet të cilat i ndërmarrin organizatat për të cilat qeveria sovjetike nuk ndjehet përgjegjëse.

Politika e cila depërton në këto dy plane është e llogaritur në atë që t'i shërbej qëndrimeve të parimeve themelore të paraqitura në kreun prej A deri në D. Aksionet të cilat ndërmerrin në secilin nga ato dy plane, do të ndryshojnë dukshëm, mirëpo ato do të jenë unike për nga qëllimet, sinkronizimi dhe efekti.

Në planin zyrtar duhet të llogarisim me këtë, me sa vijon: A. Politika e brendshme sovjetike, me çdo kusht do t'i përkushtohet forcimit të fuqisë dhe prestigjit të shtetit sovjetik; industrializimit intensiv ushtarak; zhvillimit maksimal të forcave të armatosura; ngritjes së madhe për të tërhequr vëmendjen dhe për të impresionuar botën e jashtme; fshehtësisë permanente në punët e brendshme me qëllim që të fshihihi dobësitë kurse kundërshtari të mbahet në paqartësi.

B. Bashkimi Sovjetik do të bëjë përpjekje që të zgjerojë kufijtë zyrtar të fuqisë së vet sa herë që për këtë të jepen mundësitë, kushtet e volitshme. Aktualisht, për momentin këto mundësi, këto kushte, këto përpjekje janë të kufizuara ndaj pikave të caktuara të shteteve fqinje për të cilat këtu konsiderojnë se janë nevojat strategjike të

drejtpërdrejta, siç janë Irani, Turqia, eventualisht Bornholmi. Mirëpo edhe pikat tjera mund të vijnë në shprehje, konsiderim në cilën do kohë, për aq sa politika e fshehtë sovjetike të zgjerohet në territoret e reja. Kështu, nga ndonjë qeveri "mike" persiane do të mund të kërkohej që Rusisë t'i lejohej ndonjë lima në Gjirin Persik. Nëse Spanja do të bie nën sundimin e komunistëve, atëherë do të mund të iniciohej çështja e ndonjë baze sovjetike në Gjibraltar. Mirëpo, kërkesat e tilla do të shfaqen në nivelin zyrtar vetëm atëherë kur të përfundojnë ato përgatitjet jozyrtare.

C. Rusët jozyrtarisht do të marrin pjesë në organizatat ndërkombëtare aty ku do t'u jepet rasti që të zgjerojnë sundimin sovjetik, përkatësisht të dobësojnë fuqinë e tjerëve. Në institucionin e OKB-së, Moska nuk e sheh mekanizmin e një shoqërie stabile botërore, të mbështetur në interesat reciproke dhe qëllimet e të gjithë kombeve, por e sheh arenën e përshtatshme për arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura. Derisa këtu, pra në Rusi të mbahet qëndrimi se OKB-ja shërben për këtë qëllim, sovjetët do të ngelin në te. Mirëpo, nëse rusët në çfarëdo rasti vijnë deri të përfundimi se ajo e vështirëson ose e pamundëson e realizimin e aspiratave, dëshirave të tyre, pra zgjerimin e fuqisë, sundimit të tyre, dhe nëse në mjetet tjera shohin gjasat më të mëdha për realizimin e qëllimeve të tilla, ata nuk do të hezitojnë ta lëshojnë OKB-në. Por, kjo do të thoshte se ata ndjehen aq të fortë, fuqishëm që me tërheqjen e tyre të mund të shkatërrojnë unitetin e popujve tjerë, të paaftësojnë OKB-në si kërcenim të qëllimeve të tyre ose sigurinë e tyre dhe ta ndërrojnë me ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar i cili do të jetë më frytdhënëse nga aspekti, pikëpamja e tyre. Kështu qëndrimi sovjetik ndaj OKB-së në të shumtën do të varet nga lojaliteti i popujve tjerë ndaj asaj organizate, si dhe nga fuqia, vendosmëria dhe kohezioni me të cilin ata popuj në OKB e mbrojnë konceptin për jetën paqedashëse dhe të sigurt ndërkombëtare të cilën ajo organizatë, sipas bindjes sonë e paraqet. Theksoj se, Moska nuk e ndjen ndonjë besnikëri abstrakte ndaj idealeve të OKB-së.

Qëndrimi i saj, ndaj kësaj organizate esencialisht do të jetë pragmatik dhe taktizues.

Rusët aspironjë ta zgjerojnë komunizmin

D. Në aspektin e territoreve koloniale dhe të popujve të pazhvilluar ose të popujve të varur, në varësi, politika sovjetike madje edhe në planin zyrtar do të jetë e orientuar në dobësimin e fuqisë, ndikimit dhe kontaktit me vendet e zhvilluara perëndimore, me parashikimin se me suksesin e asaj politike do të krijohet hapësira në të cilën më lehtë do të depërtoj komunizmi sovjetik. Kështu, kërkesat e sovjetëve për të marrë pjesë në aranazhmanet për përkujdesjen nuk paraqet aq dëshirën që të fitohen, merren kanalet e rëndësishme për realizimin e ndikimit sovjetik aq sa dëshirën që të fitohet pozita nga i cili do të vështirësohet dhe pengohet ndikimi i Perëndimit në ato pika. Nuk mund të thuhet se motivi i parë është përjashtuar tërësisht, mirëpo për këtë motiv sovjetët angazhohen rrugëve dhe mënyrave të tjera. Prandaj, mund të presim që sovjetët gjithkund do të kërkojnë pjesëmarrje në përkujdesje ose në aranzhmane të ngjashme dhe do t'i përdorin ato pozicione të fituara për dobësimin e ndikimit perëndimor te popujt përkatës.

E. Rusët energjikisht do të përpiqen t'i forcojnë përfaqësitë sovjetike në ato vende në të cilat do t'i hetojnë mundësitë e rëndësishme të kundërvënies qendrave perëndimore të fuqisë, dhe që me ato vende t'zhvillojnë lidhjet zyrtare. Kjo vlen reciprokisht për pikat e largëta siç janë Gjermania, Argjentina, vendet e Lindjes së Mesme etj. F. Rreth çështjeve të ekonomisë ndërkombëtare, me politikën sovjetike do të sundoj synimi, animi, pretendimi për autarkinë e Bashkimit Sovjetik dhe të viseve përreth që janë nën dominimin e tij si tërësi. Mirëpo, kjo do të jetë ajo politika e fshehtë. Sa i përket linjës zyrtare, situata ende nuk është e qartë. Që nga përfundimi i luftës, qeveria sovjetike në lidhje me tregtinë e jashtme ka dëshmuar një mospranimin, mosdeklarim, përmbajtje të çuditshme. Nëse paraqiten shanset, gjasat për kredi afatgjate të përmasave të gjëra, atëherë qeveria sovjetike ndoshta serish,

siç ka vepruar edhe në vitet e tridhjeta, me fjalë boshe do të shpreh dëshirën për të marrë pjesë në këmbimet ndërkombëtare ekonomike. Përndryshe, është e mundur që tregtia e jashtme sovjetike, kryesisht do të kufizohet në, sferën vetjake, në sferën sovjetike të sigurisë, duke përfshirë edhe pjesët, territoret e okupuara në Gjermani, dhe kështu zyrtarisht t'ia kthej shpinën parimit të bashkëpunimit të përgjithshëm ekonomik mes popujve.

A funksionon fshehurazi Kominterni?

G. Në aspektin e bashkëpunimit kultural, gjithashtu me fjalë do të shprehjet dëshira që të thellohen, shtohen, intensifikohen lidhjet kulturele mes popujve, mirëpo do të kihet kujdes që në praktikë të mos shprehjet në ndonjë mënyrë e cila d të mund të dobësojë sigurinë e popullit sovjetik. Në këtë aspekt, plan, politika sovjetike, në manifestimet e veta të vërteta, do të kufizohet në aspekte të kontrollimit të rreptë vizitave zyrtare dhe të ceremonive të shoqëruara me votkë dhe fjalime kurs pa efekte të përhershme. H. Jashtë kësaj, marrëdhëniet zyrtare sovjetike me qeveritë e huaja të caktuara do të zhvillohen, ecin atyre rrjedhave që do të mund të quhen "korrekte" me kusht që, përkundër marrëdhënive të mira sjelljeve, ashpër do të kujdesen për autoritetin e Bashkimit Sovjetik dhe përfaqësuesve të tyre, dhe në mënyrë pedante do të kujdesen për protokollin.

IV. Çfarë mund të presim në zbatimin e parimeve themelore të politikës sovjetike në planin zyrtar dhe atë të nëndheshëm, pra në planin për të cilin qeveria sovjetike nuk ndihet, konsiderohet përgjegjëse.

Për realizimin e politikës në këtë plan përdoren forcat vijuese, e mëposhtme:

A. Bërthamat e partive komuniste në vendet e huaja. Shumë persona të cilat e përbëjnë këtë kategori gjithashtu mund të paraqiten dhe të veprojnë në funksionet reciproke publike të pa lidhura, mirëpo ata në të vërtetë bashkëpunojnë ngushtë si udhëheqje e fshehtë e komunizmit sovjetik, si kominternën e fshehtë punën e të cilës repretësisht e kontrollon, e koordinon dhe e drejton Moska. Është me rëndësi të mbahet mend se ato bërthama në të vërtetë veprojnë përmes kanaleve të fshehta edhe pse partitë të cilave ato u takojnë janë legale.

Si planifikonte Bashkimi Sovjetik ta shkatërronte kapitalizmin - Perëndimin?

Roli dhe veprimi i lëvizjeve pansllaviste

B. Masat e anëtarësisë së partive komuniste. Duhet qartë të studiohen ato dhe personat e përmendur nën A. Ky dallim, viteve të fundit është bërë shumë më i gjerë. Derisa më herët partitë e jashtme komuniste kanë paraqitur një përzjerje të çuditshme të konspiracionit dhe të veprimtarisë ilegale, (edhe nga pikëpamja e Moskës shpesh të papërshtatshme), tani puna konspirative është përqendruar kryesisht në rrethin e fshehtë të ngushtë dhe të organizuar, derisa masat partiake - të cilat më aspak nuk njihen me shënimet e sakta për lëvizjen - vihen përpara si ihtar qëllimimë të tendencave të caktuara politike përbrenda vendeve të veta, dhe vërtet nuk kanë lidhje për lidhjet komplotiste me vendet tjera. Vetëm në disa vende ku numerikisht janë më të fort, fuqishëm, komunistët paraqiten tani normalisht dhe veprojnë si trup unik. Sipas rregullave ata depërtojnë në organizatat tjera, në të cilat dyshimi nuk bie lehtë se janë armë e qeverisë sovjetike, me qëllim që, mundësisht, në ta të ndikohet ose të udhëhiqet me ta, kjo gjithnjë me qëllim që detyrat e veta t'i kryejnë më me endje përmes organizatave (paravane) të tilla sesa drejtpërdrejt me aksione si parti e veçantë politike.

C. Shumica e shoqërove të ndryshme nacionale ose e organizatave në të cilat mund të depërtohet dhe të udhëhiqet me to ose të ndikohet tek ato, siç janë p. sh. sindikatat, lidhjet e rinisë, organizatat e grave, grupet kulturele, revistat liberale, shtëpitë botuese etj.

D. Organizatat ndërkombëtare në të cilat po ashtu mund të depërtohet me veprimtarinë përmes komponentëve të tyre nacionale. Mes tyre theksohen, veçohen organizatat sindikale, të grave dhe ato të rinisë. Në lidhje me këtë, veçmas, gati se rëndësia vitale i jepet lëvizjes ndërkombëtare punëtore. Në te Moska sheh mundësinë që në planet sovjetike t'i shtyjë qeveritë perëndimore në plan të dytë dhe të ndërtoj rrjetin ndërkombëtar të mbrojtësve të cilët mund të detyrojnë qeveritë në vendet e ndryshme në hapat në pajtim me interesat sovjetike dhe njëherit t'i paralizojnë aksionet të cilat nuk janë në interes, nuk janë të përshtatshme për BRSS-në. E. Kisha ortodokse ruse me degët

e saj në botën e jashtme, dhe përmes saj edhe Kisha ortodokse lindore përgjithësisht. F. Lëvizjet pansllaviste dhe të tjera (azerbejgjane, jermene, proturke etj.) janë themeluar, mbështetur në grupet rasore përbrenda Bashkimit Sovjetik. G. Qeveritë ose grupet qeveritare të gatshme, të vullnetshme që në këtë ase atë masë të paraqein, përfaqësojnë interesat sovjetike, ashtu siç janë tani qeveria bullgare dhe ajo jugosllave, regjimi lindoriranian, komunistet kinez, etj. Në shërbim të gjerë të BRSS-së mund të vihen jo vetëm aparatet propagandistike por edhe politikat reale, të vërteta të atyre regjimeve.

Nxitja e urrejtjes antiperëndimore

Mund të pritet që pjesët përbërëse të atij mekanizmit të gjerë, sipas afiniteteve të tyre individuale, të përdoren kështu: 1. Për nxitjen e potencialit të përgjithshëm politik dhe strategjik të fuqive të mëdha perëndimore. Do të investohet në përpjekjet që në ato vende të thyhet, shkatërrohet vetëbesimi, krenaria nacionale, të minohen masat e mbrojtjes nacionale, të forcohen pakënaqësitë, trazirat

shoqërore dhe ekonomike, pra do të përdoren të gjitha format e shkatërrimit, përcarjes. Të gjithë ata të cilët qoftë ekonomikisht ose në pikëpamje rasore janë të rrezikuar do të nxiten që përmirësimin e pozitës së tyre të mos e kërkojnë në marrëveshjet dhe kompromiset, por në luftën për shkatërrimin e dhunshëm të elementeve tjera të shoqërisë. Me këtë rast të varfrit do t’u kundërvihen, do të ngritën kundër të pasurve, zezakët ndaj të bardhëve, të rinjtë ndaj pleqve, të moshuarve, ardhacakët ndaj vendasve etj. 2. Në planin jozyrtar, përpjekje të mëdha do të investohen veçmas që të dobësohet fuqia dhe ndikimi i fuqive perëndimore në popujt kolonial, të pazhvilluar ose në popujt e varur. Në këtë plan nuk do të zgjidhen mjetet. Gabimet dhe dobësitë e administratës perëndimore koloniale do të shkatërrohen, diskreditohen pamëshirshëm. Rrymat liberale në vendet perëndimore do të mobilizohen me qëllim të dobësimit të politikës koloniale. Tek popujt e varur do të nxitet, ndezët urrejtja. Dhe derisa ata do t’i përkrahin që të kërkojnë pavarësinë nga fuqitë perëndimore, ndërkohë do të përgatiten mekanizmat marionete politike, nën

kontrollin sovjetik, të cilat mekanizma me rastin e fitimit të pavarësisë do ta marrin pushtetin. 3. Atje ku qeveritë janë kundër realizimit të interesave sovjetike do të bëhet presion që ato të ndërrohen. Kjo mund të ndodhë atje ku qeveritë pandërprerë u kundërvihen qëllimeve të politikës së jashtëm sovjetike (Turqia, Irani), ku ato pengojnë depërtimin e komunizmit në territorin e tyre (Zvicra, Portugalia), ose atje ku që moti janë konkurrent të rrezikshme, si qeveria laburiste në Angli, në luftë për arsyetimin moral të elementeve mbi të cilat për komunistët është me rëndësi të sundojnë. (Nganjëherë në një rast gjejmë edhe nga dy prej këtyre elementeve. Atëherë reaksioni komunist bëhet veçmas i ashpër dhe i tërbuar.) 4. Në vendet e huaja komunistët sipas rregullave do të punojnë, angazhohen në shkatërrimin e të gjitha formave të pavarësisë – ekonomike, politike ose morale. Sipas sistemit të vet ata mund të llogarisin vetëm në njerëz të cilët plotësisht kanë rënë në varësi nga ndonjë fuqi më e madhe. Për ata të nëmur janë ata të cilët materialisht janë të pavarur si persona të caktuar zyrtar, afarist, pronar të tokave, pasurive të

patundshme, fermerë me prestigj dhe pozitë të mirë materiale, dhe të gjithë ata të cilët në vendin e tyre kanë autoritet dhe janë persona të çmuar, si fjala vie politikanët etj. Nuk është e rastësishme pse në BRSS funksionarët lokal gjithmonë, përherë lëvizin nga një funksion në tjetrin.

Pse sovjetikët nxisnin antibritanizmin amerikan?

5. Do të ndermirët çdo gjë me qëllim që të nxitet shpartallimi, përcarja midis fuqive kryesore perëndimore. Amerikanët do t’i orientojnë, mësyjnë kah antibritanizmi, kurse britanikët në bisedimet antiamerikane. Në kontinentin evropian, njerëzit do t’i mësojnë, duke përfshirë me këtë qëllim edhe gjermanët, që t’i urrejnë të dy fuqitë anglosaksone. Aty ku ka dyshim ata do ta thellojnë, zgjerojnë. E aty ku nuk ka, ajo do të mbjellët. Me të gjitha fuqitë do të punohet në diskreditimin dhe pengimin, evitimn e çfarëdo përpjekje që në mesin e shteteve të krijohet ndonjë unitet ose çfarëdo lidhje prej të cilës Rusia do të ishte e përrjashtuar. Prandaj organizatat ndërkombëtare të cilat nuk janë të nënshtruara ndikimeve pse kontrollit komunist – Kisha

katolike, koncernet ekonomike ndërkombëtare, ose vëllazërimi ndërkombëtar i njerëzve me prejardhje mbretërore ose aristokratike, duhet të presin që të gjenden nën flakën e atij zjarri. 6. Përgjithësisht, të gjitha përpjekjet sovjetike në planin jozyrtar ndërkombëtar sipas karakterit të tyre do të jenë negative dhe destruktive, të orientuara në dobësimin e burimeve të fuqive të cilat janë jashtë kontrollit sovjetik. Kjo, thjesht është në pajtim me bazat, konceptet sovjetike, nga ndjenja, instinkti se kompromis me fuqinë konkurruese, konkurrente, rivale nuk mund të ketë dhe se puna konstruktive mund të fillojë vetëm pasi që pushteti, sundimi komunist të bëhet dominant. Mirëpo, prapa gjithë kësaj vazhdimisht, pandërprerë do të bëhet presion me qëllim të depërtimit dhe sundimit me pozitë kyçe në administratë, dhe veçmas në aparatin policor të vendeve të huaja. Regjimi sovjetik është regjim policor par excellence, i kultivuar në gjysmëvetëdijen e errët të policisë cariste, i mësuar në shprehinë që të mendoj kryesisht nga pikëpamja e pushtetit policor. Kjo, kurrë nuk duhet të hiqet nga mendja me rastin e vlerësimit të motiveve sovjetike. (Vijon)

Ajo që po ndodhë sot në Serbi, mund ta ndryshojë përgjithmonë Ballkanin

Është një luginë në Serbi, quhet lugina Jadar, ku me mjete të tjera po luftojnë Bashkimi Evropian, SHBA-të, Rusia dhe Kina. N’ate luginë janë zbulu rezerva të mëdha të mineralit që quhet lithium, vlera e të cilit viteve të fundit ka hypë shumë, sepse ai mineral përdoret për prodhimin e baterive të veturave elektrike, industri kjo që po lulëzon, e ku po garojnë fort Lindja dhe Perëndimi. Aktualisht primatin për prodhimin e baterive e ka Kina. Kjo ka bërë që ky shtet komunist ta ketë një avantazh në tregun global, sepse veturat elektrike të prodhuara në Kinë, për shkak të kësaj lande, janë shumë më të lira sesa ato të prodhuara në Perëndim. Ka edhe arsye tjera, por kjo është arsye bukur madhore. T’kthehmi në Serbi. Fillimisht qeveria e Serbisë licencen për me e hapë minierën në Jadar, për me nxjerrë lithium, ia kishtë dhënë kompanisë multimilirdëshe Rio Tinto, që është një kompani multinacionale, britaniko - australiane. Mirëpo për shkak të protestave dhe kundërshtimeve të mëdha kundër asaj miniere, prej frikës që kjo mundet me i ndiku në zgjedhje, qeveria e Serbisë në vitin 2022 e kishte anuluar lejen. Megjithatë loja nuk ka përfundu. Një vizitë e rrufeshme në Serbi, para disa ditëve, e kancelarit Scholz, e ka



rikthi përsëri në rend të ditës punën e minierës. Serbia prapë është pajtuar që me rifillu projektin, duke i acaru nervat e partnerëve strategjik, siç janë Rusia dhe Kina. Perëndimi nuk ka heq dorë prej dëshirës për me e pasë nën kontroll atë minierë, që më shumë se sa dëshirë është nevojë, e më shumë se sa nevojë, është plan gjeostrategjik. Nën 1: Sipas një shkrimi në Neë York Times, Bashkimi Evropian nuk ka me mujtë me e realizu planin zero emitim të dioksidit të karbonit deri në vitin 2050, nëse Serbia nuk e jep këtë minierë. Rezervat aty janë masive, kurse investimi që ka me u

bërë aty është rreth 3 miliardë dollarë. Do të hapen mbi 20 mijë vende të punës; Nën 2: Përmes kontrollit të kesaj miniere, Perëndimi po shpreson me e marrë edhe kontrollin e Serbisë, prandaj sipas Neë York Times, Rusia fshihet prapa protestave masive në Serbi, duke i organizu grupet ekstremiste nacionaliste. Nën 3: Një lidhje e fortë ekonomike e Serbisë me Perëndimin, përmes një investimi strategjik, është goditje për Rusinë, por ndoshta ma shume për Kinën, sepse kjo minierë ia relativizon avantazhin e Kines në fushën e baterive për veturat elektrike.

Aktualisht ne botë jane tri tema të rëndësishme: Mikrochipat, Lithiumi dhe Inteligjenca Artificiale. Për fatin tonë të keq Ura mbi Lumin Ibër, Miniera e Trepçës, Thëngjilli i Obiliqit dhe Konvertimet ne Kishë e Llapushnikut nuk e kanë ndonjë peshë të madhe globale. Çka po du me thanë osht kjo: Perderisa na jena marre me tema absolutisht te kota, kundershtari i jone kryesor ne rajon, Serbia, osht bo faktor interesant ne rrafshin global, fillimisht me shitjen e armeve per Ukrainen, e tash me minieren e Lithiumit, si favore per Perendimin, ndersa retorikisht vazhdon me kane aleate e Rusise dhe Kines. Është e

pamundur me supozu së sa larg mundet me vazhdu Serbia me ecë në dy rrugë të ndryshme njëkohësisht. Ajo çka është lehtë me supozu është që për dallim prej nesh, Serbia po merr pjesë në tryezat ndërkombëtare me resurse të prekshme, të shitshme dhe të vlefshme, si armët dhe mineralet, kurse Kosova vazhdon me qenë peng i ligjëratave boshe ideologjike të krerëve të shtetit, mbi demokracinë dhe socialdemokracinë. Qysh thonë, nëse nuk je në tryezë, je në meny. Qartazi Kosova nuk është në tryezë. Kryeministri jonë, depërtimin ma të rendesishem diplomatik të disa viteve të fundit e ka pjesëmarrjen në Konventën e Partisë Demokratike në Chicago, bashkë edhe me 20 mijë veta të tjerë. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, vazhdon të eksportoj nervozë, histeri dhe mllef të pashpjegueshem. Ajo edhe dje gjenjeu për rastin e përfshirjes së axhes burrit të vet në një skadal të tmerrshëm, ku ishin abuzuar seksualisht tri vajza të moshës rreth 10 vjeç. Osmani është aq e vogël, sa edhe ma tutje nuk ka arritë me shprehë keqardhje minimale për viktimat e atij akti monstruoz. Për këtë një ditë tjetër, shumë më shumë.

Rezoluta e Bujanit: Institucioni i vetëvendosjes në aspektin kushtetues deri te shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe përkushtimi i saj për t’u bërë anëtare e plotë e komunitetit ndërkombëtar



Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Gjatë Luftës së Dytë Botërore Jugosllavia dhe Shqipëria u pushtuan nga forcat fashiste italiane dhe gjermane. Në këtë periudhë të trazuar, lëvizjet komuniste në të dy vendet organizuan forca të rezistencës për t’i luftuar pushtuesit. Në këtë kontekst, më 31 dhjetor 1943 dhe 1-2 janar 1944, u mbajt Konferenca e Bujanit në një fshat në Malësinë e Gjakovës, ku morën pjesë përfaqësues të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit, si dhe delegatë nga Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe Partia Komuniste e Shqipërisë.

Përmbajtja e Rezolutës së Bujanit

Rezoluta e Bujanit u miratua si rezultat i kësaj konference. Ajo përmbante disa pika kyçe: -E Drejta e Vetëvendosjes: Rezoluta deklaronte qartë se populli i Kosovës kishte të drejtën të vendoste vetë për të ardhmen e tij politike pas çlirimit nga pushtuesit. Ky parim i vetëvendosjes nënkuptonte se populli kishte të drejtë të vendoste nëse do të bashkohej me Shqipërinë apo do të mbetej në kuadër të Jugosllavisë. -Lufta Kundër Pushtuesve: Dokumenti theksonte rëndësinë e bashkimit të forcave shqiptare dhe jugosllave në luftën kundër fashizmit. Lufta për çlirim kombëtar u konsiderua si prioriteti më i madh dhe më i ngutshëm. -Premtimi për Referendum: Rezoluta përmbante një premtim se pas përfundimit të luftës, populli i Kosovës do të kishte mundësinë të shprehë vullnetin e tij përmes një referendumi të lirë dhe demokratik për të vendosur fatin e vet.

Konferencën e Prizrenit mbajtur më 7-10 korrik 1945

Kjo Konferencë ishte një ngjarje e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës dhe çështjen e tyre kombëtare. Konferenca u thirr nga autoritetet jugosllave pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe kishte për qëllim të trajtonte statusin politik të Kosovës pas luftës. Në këtë konferencë, morën pjesë përfaqësues të ndryshëm shqiptarë, kryesisht figura politike dhe ushtarake të cilët kishin qenë aktivë gjatë luftës. Megjithatë, organizimi dhe rezultati i konferencës ishin të diktuar nga autoritetet komuniste serbe-jugosllave, të cilët kishin interesa të qarta për integrimin e Kosovës në

Federatën Jugosllave. Rezoluta e Konferencës së Prizrenit përfshinin vendimin për t’i bashkuar Kosovën dhe rajonet e tjera me popullsi shqiptare në Serbi, duke i mohuar kështu aspiratat e shumicës shqiptare për vetëvendosje dhe për bashkimin me Shqipërinë. Kjo konferencë shënoi fillimin e një periudhe të re represioni dhe diskriminimi ndaj shqiptarëve në Kosovë, të cilët u përballën me shtypje të vazhdueshme nga autoritetet serbe-jugosllave gjatë viteve të ardhshme. Fatkeqësia e shqiptarëve pas Konferencës së Prizrenit qëndronte në faktin se ata humbën mundësinë për të vendosur vetë për të ardhmen e tyre politike. Vendimet e kësaj konference vendosën bazat për një periudhë të gjatë tensioni dhe konflikt ndërmjet shqiptarëve dhe autoriteteve serbe-jugosllave, që vazhdoi deri në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe luftërat e viteve 1990.

Pasojat e Rezolutës

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht premtimeve të Rezolutës së Bujanit, e drejta për vetëvendosje nuk u realizua. Në vend të kësaj, në vitin 1945, Kosova u integrua në Republikën Federative të Jugosllavisë si një krahinë autonome brenda Republikës së Serbisë. Kjo nënkuptonte se vendimi për statusin e Kosovës nuk u bazua në një referendum popullor, por në vendimet e lidershipit komunist serb-jugosllav.

Rezoluta në Kontekstin e Pasluftës

Ndërkohë që Rezoluta e Bujanit simbolizonte shpresën dhe aspiratat e popullit të Kosovës për vetëvendosje, moszbatimi i saj çoi në tensione të mëtejshme etnike dhe politike në dekadat që pasuan. Shqiptarët e Kosovës ndiheshin të tradhtuar dhe të shtypur nga regjimi serbo-jugosllav, gjë që kontribuoi në konfliktet e mëvonshme dhe luftën për pavarësi. Periudha Pas Luftës së Dytë Botërore dhe Konfliktet e Mëvonshme Pas integritetit të Kosovës në Jugosllavi, tensionet mes shqiptarëve dhe serbëve në rajon vazhduan të rriten. Politikat e asimilimit dhe shtypjes nga regjimi komunist serb-jugosllav nxitën pakënaqësi dhe rezistencë nga ana e shqiptarëve të Kosovës. Kjo periudhë e tensioneve kulmoi me shpërbërjen e Jugosllavisë në vitet 1990 dhe luftën e Kosovës në vitet 1998-1999.

Lufta e Kosovës dhe shpallja e Pavarësisë

Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave të Serbisë dhe Malit të Zi, që përfundoi me ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999. Pas përfundimit të luftës, Kosova u

vu nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara për disa vite, derisa më 17 shkurt 2008 shpalli pavarësinë e saj. Edhe pse këto aspirata të popullit të Kosovës nuk u realizuan në plotëni, Rezoluta e Bujanit mbetet një dokument pikë referimi dhe frymëzim për brezat e ardhshëm të shqiptarëve të Kosovës, duke kulmuar në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Si u organizua Konferenca e Bujanit?

Kjo konferencë u organizua nga lëvizja nacionalçlirimtare shqiptare dhe jugosllave gjatë Luftës së Dytë Botërore. Rezoluta e Bujanit e cila u miratua në këtë Konferencë, ishte një akt politik dhe ushtarak që deklaronte se populli shqiptar i Kosovës dhe rretheve përreth kishte të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje dhe bashkim me Shqipërinë. Ky ishte një qëndrim i rëndësishëm, pasi për herë të parë njohu të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje, një çështje që më parë ishte injoruar ose mohuar nga fuqitë e jashtme dhe regjimet që kishin kontrolluar rajonin. Statusi i Kosovës deri në shpalljen e pavarësisë Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia u riorganizua nën udhëheqjen e Josip Broz Titos. Pavarësisht premtimeve të bëra në Rezolutën e Bujanit, Kosova u bë një krahinë autonome brenda Republikës të Serbisë, pjesë e Federatës Jugosllave, dhe nuk u bashkua me Shqipërinë. Gjatë viteve të pasluftës, shqiptarët në Kosovë përjetuan periudha të ndryshme represioni dhe autonomi të kufizuar. Në vitin 1974, Kushtetuta Jugosllave i dha Kosovës një shkallë të lartë autonomie, por kjo autonomi u revokua në vitin 1989 nga Slllobodan Millosheviçi, udhëheqësi serb, duke çuar në një periudhë të tensionuar dhe represioni të rritur. Në vitet '90, situata në Kosovë u përkeqësua me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe luftërat në Ballkan. Populli shqiptar në Kosovë kërkoi gjithnjë e më shumë pavarësinë nga Serbia, gjë që çoi në luftën e Kosovës (1998-1999). Pas ndërhyrjes së NATO-s në 1999, Kosova u vu nën administrimin e Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Shpallja e Pavarësisë Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 17 shkurt 2008. Kjo pavarësi e shpallur nga Parlamenti i Kosovës, (parlament nën monitorimin ndërkombëtar) është njohur nga shumë vende anëmbanë botës, por Serbia dhe disa vende të tjera ende nuk e njohin atë. Pavarësia e Kosovës shënon një kapitull të ri në historinë e saj dhe një përmbushje të pjesshme të aspiratave të shpallura në Rezolutën e Bujanit. -Rezoluta e Bujanit, njësohet nga një mbledhje e përfaqësuesve shqiptarë të Kosovës , është një dokument i rëndësishëm historik që trajtoi çështjen e statusit të Kosovës në periudhën pas Luftës së

Dytë Botërore. Rezoluta theksonte të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje, duke përfshirë të drejtën për t'u bashkuar me Shqipërinë, nëse populli i Kosovës do ta dëshironte këtë. Në aspektin kushtetues, kjo rezolutë përfaqëson një përpjekje të hershme për të përcaktuar fatin e Kosovës nga vetë populli shqiptar që jetonte në këtë territor. -Rezoluta e Bujanit nuk u përkrah nga fuqitë e mëdha. Konferenca e Bujanit dhe rezoluta e saj nuk gjetën mbështetje apo njohje ndërkombëtare nga fuqitë e mëdha të kohës, si nga ish Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar apo fuqitë e tjera aleate. Për më tepër, pas Luftës së Dytë Botërore, kur çështja e Kosovës dhe e territoreve të tjera u rihap për diskutim, vendimet dhe përfundimet e Konferencës së Bujanit u kundërshtuan dhe u injoruan nga autoritetet serbe-jugosllave dhe ato ndërkombëtare. Kosova mbeti pjesë e Jugosllavisë dhe aspiratat për bashkim me Shqipërinë nuk u realizuan. -Përkundër qëllimeve dhe përpjekjeve... pas përfundimit të luftës dhe themelimit të Jugosllavisë Federale, Kosova u bë pjesë e Serbisë si një krahinë autonome, duke mos u zbatuar kështu parimet e vetëvendosjes të përfshira në Rezolutën e Bujanit. Rruga drejt shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 kaloi përmes disa fazave kyçe, duke përfshirë: -Periudha (1945-1989):Gjatë kësaj periudhe, Kosova gëzonte një farë autonomie brenda Serbisë dhe Jugosllavisë, por aspiratat për vetëvendosje dhe bashkim me Shqipërinë nuk u realizuan. Në vitin 1974, Kushtetuta e Jugosllavisë i dha Kosovës statusin e një krahine autonome me disa të drejta të zgjeruara. -Revokimi i Autonomisë (1989-1999):Në vitin 1989, Slllobodan Millosheviqi në krye të hegjemonizmit serb, revokoi autonominë e Kosovës, gjë që çoi në rritjen e tensioneve dhe konflikteve etnike. Gjatë kësaj periudhe, shqiptarët e Kosovës krijuan institucione paralele dhe zhvilluan një rezistencë paqësore që kulmoi me luftën e vitit 1998-1999. -Lufta e Kosovës dhe Intervenimi Ndërkombëtar (1999):Konflikti u përshkallëzua në një luftë të armatosur mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave serbe, e cila çoi në një ndërhyrje ushtarake të NATO-s në mars 1999. Pas përfundimit të luftës, Kosova u vendos nën administrimin e Kombeve të Bashkuara sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit. -Periudha e Administrimit Ndërkombëtar (1999-2008):Gjatë kësaj periudhe, Kosova u administrua nga UNMIK-u dhe u zhvilluan institucione të përkohshme vetëqeverisëse. Procesi i negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës përfshiu diskutime mes palëve të ndryshme, të udhëhequra nga i dërguari

special i OKB-së, Martti Ahtisaari. -Shpallja e Pavarësisë (2008): Pas dështimit të negociatave për një zgjidhje të përbashkët, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Kjo shpallje u njoh nga shumë vende, por mbetet e kontestuar nga Serbia dhe disa vende të tjera. Në kontekstin kushtetues, shpallja e pavarësisë së Kosovës u mbështet nga një paketë e Ahtisaarit që parashikonte mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe krijimin e një sistemi qeverisës demokratik. Kushtetuta e Kosovës, e miratuar më 15 qershor 2008, pasqyron këto parime dhe synon ndërtimin e një shteti të ri që respekton të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve të saj. Procesi i integritetit të Kosovës dhe hapat kyç në sfida të rëndësishme: -Njohja Ndërkombëtare: Deri tani, mbi 100 vende kanë njohur pavarësinë e Kosovës, përfshirë shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara etj. Megjithatë, disa vende, përfshirë Serbinë, Rusinë dhe disa vende të tjera, ende nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. -Bashkimi Evropian: Kosova ka një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi (MSA) me BE-në, e cila përbën një hap të rëndësishëm drejt integritetit në BE. Megjithatë, rruga drejt anëtarësimit të plotë është e gjatë dhe kërkon reforma të shumta në fusha të ndryshme, si sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe zhvillimi ekonomik. -Organizatat Ndërkombëtare: Kosova është anëtare e disa organizatave ndërkombëtare, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankën Botërore. Përpjekjet për t'u anëtarësuar në organizata të tjera, si Kombet e Bashkuara dhe INTERPOL, kanë hasur në kundërshtime të ndryshme politike. -Dialogu me Serbinë: Një nga kushtet kryesore për integrimin ndërkombëtar të Kosovës është normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja është një proces i vazhdueshëm që synon zgjidhjen e çështjeve të hapura mes dy vendeve. -Partneritetet Strategjike: Kosova ka ndërtuar partneritete strategjike me disa vende kryesore, siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, etj, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e saj politike dhe ekonomike. Integrimi i Kosovës në struktura ndërkombëtare është një proces kompleks dhe sfidues, por progresi i bërë deri më tani tregon përkushtimin dhe vullnetin e Kosovës për t'u bërë anëtare e plotë e komunitetit ndërkombëtar, ku në këtë kontekst përveç BE, rol dominant-kyç duhet të kenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Marrë në tërësi të gjitha këto institute të së drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare lidhen me të drejtën e vetëpërcaktimit të popullit shqiptar të Kosovës për të ardhmen e tij.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Drita sonte përballlet me Legian në Ligën e Konferencës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 GUSHT - Skuadra e Dritës sot (e enjte) e zhvillon ndeshjen e parë në “play-off”-in e Ligës së Konferencës. Kundërshtarë e gjilanasve është Legia, kurse ndeshja zhvillohet në stadiumin “Wojsla Polskiego” të Varshavës. Kjo ndeshje nuk do të jetë aspak e lehtë për klubin e vetëm që është ende pjesëmarrës në garat evropiane, pasi ka luajtur në finalët e të gjitha ligave

evropiane, Ligën e Kampionëve, Ligën e Evropës dhe Ligën e Konferencës. 15 herë kampionët e Polonisë janë ekip i njohur për Dritën, sepse në shtator të vitit 2020 ishin takuar për herë të parë në raundin e tretë të UEFA Europa Ligue e që, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19, fituesi përcaktohej vetëm nga një ndeshje dhe shorti përcaktoi që të ishim mysafirë. Takimi ishte zhvilluar në Varshavë në stadiumin “Marshall Jozef Pilsudski” në kohë pandemie në masa të rrepta

sigurie dhe dyert e stadiumit ishin të mbyllura për shikues. Ndeshja u mbyll me rezultat 2-0 për ekipin vendas dhe ne u eliminuam nga garat evropiane. Më pas Legia në fazën e “play-off” u eliminua nga ekipi Qarabag, ku pësoi disfatë 3-0. Kjo është hera e parë që skuadra e Dritës ka arritur deri në këtë fazë, kurse synim është kualifikimi në grupet e Ligës së Konferencës, ku do ta “mbushte” arkën e klubit me 4 milionë euro. Ndeshja kthyesë zhvillohet në stadiumin “Fadil Vokrri” më 29 gusht.

Xhiroja e tretë në Superligë, sërish shtyhet një ndeshje

Prishtinë, 21 gusht - Superliga e Kosovës do të vazhdojë në fundjavë, por sërish me vetëm katër ndeshje që do të zhvillohen. Federata e Futbollit të Kosovës tanimë ka publikuar orarin për xhiron e tretë, derisa sërish është shtyrë ndeshja e Dritës. Klubi gjilanas po luan në garat evropiane dhe ka shtyrë dy ndeshjet e para ndaj Malishevës dhe Prishtinës, por edhe tani ndaj Suharekës në xhiron e tretë. Drita do të përballlet në dy ndeshjet e “play-off”-it të Ligës së Konferencës me Legia Varshavën dhe kjo është arsyeja që ka bërë kërkesë për shtyrjen e ndeshjeve. Ndërkohë në xhiron e tretë pritet përballje mjaft interesante me Llapi - Malisheva, që është ndeshja kryesore dhe që zhvillohet të shtunën. Po këtë ditë



interesant pritet të jetë edhe dueli në mes të Ferizajt dhe Prishtinës, derisa në Klinë Dukagjini përballlet me Gjilanin. Të dielën në program është

vetëm një sfidë për t'u zhvilluar, ku kampioni në fuqi, Ballkani, pret Feronikelin '74. Nga kjo xhiro ndeshjet do të fillojnë nga ora 16:00.

SHKURT

Ferizaj përforcohet me një mesfushor kroat

Skuadra e Ferizajt është përforcuar në repartin e mesfushës. Kroati Marko Musulin do të djersijë fanellën e kësaj skuadre, derisa karrierë ka bërë edhe në Kroaci, Slloveni dhe Bosnjë. “Ju njoftojmë se kemi arritur marrëveshje me mesfushorin me tipare ofensive, kroatin Marko Musulin. Lojtari ynë i ri, që së fundmi luajti në Bosnjë, karrierën e ka filluar në Jadran LP të Kroacisë dhe është paraqitur gjithashtu në Slloveni te NK Rogaska. Musulin karakterizohet për kontrollin e mirë të topit dhe pasimet në zonë të ngushta”, thuhet në njoftimin e Ferizajt. Skuadra e Ferizajt në këtë edicion po bën gara në Superligë dhe nga dy ndeshjet e para ka regjistruar një fitore dhe një barazim.

Ramadani: Nuk shkojmë të dorëzuar ndaj Interit

Lecce e Medon Berishës dhe Ylber Ramadani e nisi dobët sezonin e ri duke u mundur 4-0 në shtëpi nga Atalanta. Ka qenë Ramadani që ka folur në lidhje me këtë takim, por edhe për sfidën e ardhshme ndaj Interit të Kristjan Asllanit: “Kishim përgatitur një ndeshje për të fituar dhe në 30 minutat e para ishin mirë, por pësuam. Pas golit të dytë ka ndryshuar komplet takimi, sepse më parë ishim kompaktë, ndërsa pjesën e dytë skuadra e humbi ekuilibrin. Atalanta është e fortë fizikisht”. “Inter? Janë kampionët e Italisë dhe një skuadër shumë e fortë, por ne nuk shkojmë të dorëzuar në ‘San Siro’. Do të kërkojmë të marrim një rezultat pozitiv”, ka deklaruar Ramadani.

Liga 1: Sezoni i ri dhe Zhegrova është ende i jashtëzakonshëm

Edon Zhegrova e ka nisur sezonin e ri në mënyrë fantastike. Ylli nga Kosova ishte prapë protagonist në ekipin e tij, Lille. 25-vjeçari e realizoi golin e dytë të skuadrës franceze pas një aksioni fantastik individual, në fitoren me rezultatin 2-0 ndaj Slavia Pragës, në ndeshjen e “play-off”-it të Ligës së Kampionëve. Pas ndeshjes, përfaqësuesin nga Kosova e ka lavdëruar faqja zyrtare e Ligës 1 përmes një postimi në rrjetet sociale. “Sezoni i ri dhe Edon Zhegrova është ende i jashtëzakonshëm”, shkroi liga franceze duke ia përcjellë postimit një flamur të Kosovës dhe një yll. Ky ishte goli i dytë për Zhegrovën në Champions pas atij ndaj Fenerbahçes së Jose Mourinhos. Zhegrova ka qenë i mahnitshëm në sezonin e kaluar, ndërsa pritet të jetë protagonist edhe në këtë edicion. Edhe pse pritej të largohej nga Lille në këtë verë për ta nisur një përvojë të re në një ekip më të fortë, duket se “Messi i Kosovës” do të jetë pjesë e ekipit francez edhe për një vit.

Zyrtare: Neueri pensionohet nga Kombëtarja e Gjermanisë

MUNCHEN, 241 GUSHT - Kapiteni i Bayern Munchenit, Manuel Neuer, ka njoftuar se është pensionuar nga Kombëtarja e Gjermanisë. Lajmin e ka dhënë vetë portieri në “Instagram”. “Kjo ditë kishte për të ardhur

në një pikë”, shpjegoi Neuer në një video të postuar nga ai. “Secili që më njeh e di se ky vendim nuk ishte i lehtë për mua. Ishin 15 vjet që nga debutimi im, kur ne luajtëm në Emiratet e Bashkuara Arabe

dhe isha ekstremisht nervoz”, shkroi tutje ai. “Personalisht, e dashurova fanellën e Kombëtares së Gjermanisë. Faleminderit shumë për këtë mundësi! Ishte kënaqësi të luaja me krejt bashkëlojtarët

dhe, po ashtu, që isha kapiten i kombëtares për shtatë vjet”, ka deklaruar Neuer. 38-vjeçari kishte debutuar me Gjermaninë në vitin 2009 dhe përfaqësuar vendin në 124 ndeshje, më shumë se çdo



Sven-Goran Eriksson thotë lamtumirë me mesazhin e fundit emocional

LONDËR, 21 GUSHT - Trajneri legjendar Sven-Goran Eriksson ka ndarë një mesazh emocional lamtumirë për botën ndërsa u afrohet fazave të fundit të betejës së tij me sëmundjen e rëndë. Ish-trajneri 76-vjeçar i Anglisë njoftoi në janar se ai ishte diagnostikuar me kancer në pankreas dhe se i kishte “në rastin më të mirë” edhe një vit jetë. Që atëherë ai ka realizuar një ëndërr të përjetshme për të menaxhuar një ekip të Liverpoolit në Anfield dhe, me familjen e tij të pranishme, suedezi ishte dukshëm emocional teksa ‘You’ll Never Walk Alone’ luajti në parandeshjen miqësore. Eriksson ka vizituar edhe stadiumet e ish-skuadrave si Gothenburg, Lazio, Sampdoria dhe Benfica, ku ka marrë një përgjigje të pabesueshme nga ata në tribuna. Tani fansat do të jenë në gjendje të shikojnë mbrapa jetën e Erikssonit në një dokumentar prekës në Prime



Video që paraqet kulmet dhe uljet e karrierës së tij të jashtëzakonshme. “Kam pasur një jetë të mirë. Mendoj se të gjithë jemi të frikësuar nga dita kur vdesim, por jeta ka të bëjë edhe me vdekjen. Duhet të mësosh ta pranosh ashtu siç është. Shpresoj se në fund njerëzit do të thonë, po, ai ishte një njeri i mirë, por të gjithë nuk do ta thonë këtë”, ka

thënë Erikssoni. “Shpresoj se do të më mbani mend si një djalë pozitiv që përpiqet të bëjë gjithçka që mund të bënte. Mos t’u vijë keq, buzëqeshni. Faleminderit për gjithçka, trajnerë, lojtarë, tifozë! Ka qenë fantastike. Kujdesuni për veten dhe kujdesuni për jetën tuaj. Dhe jetoni. Mirupafshim!”, ka përfunduar lamtumirën e tij ish-trajneri i njohur.

Sinner rezulton pozitiv në testet anti-doping, gjykata nuk e ndëshkon

ROME, 21 GUSHT - Jannik Sinner ka rezultuar pozitiv. Ky është lajmi i bujshëm që shokoi botën e tenisit botëror. 23-vjeçari italian sapo mbylli me sukses Turneun e Masterit Cinicinnati, menjëherë u bë pjesë e një problematike shumë të rëndë. Pas kryerjes së analizave tenisti italian rezultoi pozitiv pasi rezultoi se kishte marrë një substancë të ndaluar të quajtur Clostebol. Sipas Gjykatës së Pavarur, trajneri atletik i Sinnerit kishte përdorur një “spray” të blerë në farmaci për të trajtuar një prerje në gishtin e tij. Pasi produkti, që përmban substancën e diskutueshme, ishte aplikuar, fizioterapisti e trajtoi tenistin italian me një masazh pa përdorur doreza dhe duke shkaktuar kështu kontaminim. Por për faktin se Sinneri nuk ka qenë i ndërgjegjshëm për marrjen e kësaj substance dhe nuk ka treguar asnjë lloj neglizhence në përgatitjen e tij për turneun, nuk mori asnjë ndëshkim për



vijueshmërinë e aktiviteteve nga ana e gjykatës. Gjithashtu, ATP (Shoqata Ndërkombëtare e Tenistëve Botërorë), në një deklaratë lidhur me këtë çështje inkurajoi që edhe tenistë të tjerë të tregojnë kujdesin maksimal së bashku me ekipet e tyre drejt përgatitjes dhe ndjekjes së protokolleve të miratuara, në mënyrë që të

shmanget çfarëdolloj problematike lidhur me pjesëmarrjen e tenistëve në turnetë ndërkombëtarë. Mungesa e penalizimit të Sinner ka shkaktuar edhe shumë reagime. Më kryesori ishte ai i tenistit australian Nick Kyrgios i cili u shpreh se Jannick Sinner duhet të ishte shkualifikuar nga aktiviteti për të paktën dy vjet.

SHKURT

Broja huazohet tek Ipswich Town

Sulmuesi shqiptar Armando Broja ka kryer testet mjekësore me skuadrën e re Ipswich Town, tek e cila pritet të huazohet deri në fund të sezonit. Ipswichi do t’i duhet t’i paguajë 35 milionë euro për Brojën në rast se e shmang rënien nga Premierë Ligë, shkruan BBC. Broja mori pjesë në turneun parasezonal me Chelsea në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por me t’u kthyer në Londër ai iu bashkua “grupit të huazimit”, pasi u konsiderua si tepricë në skuadër.

Dy klube të mëdha turke interesohen për Manajn

Trajneri i Sivassporit, Bulent Uygun, ka deklaruar se dy klube të mëdha nga Turqia janë të interesuara për Rey Manajn dhe se bisedimet janë duke u zhvilluar. “Po takohemi edhe me ta (dy klubet turke). Negociatat me ligën saudite vazhdojnë”, ka thënë fillimisht Uygun. “Nëse numrat dhe pozicionet që duam janë në dispozicion, atëherë menaxhmenti ynë do të vlerësojë. Unë po përpiqem ta përgatis atë (Manajn) në mënyrën më të mirë, sikur ai të mbetet. Edhe pse ka mungesë stërvitje, na dha një kontribut të mirë në dy ndeshje”, ka shtuar ai. Manaj në sezonin e kaluar me klubin turk ia doli të shënonte 18 gola dhe shtoi tri asistime, duke bërë që klubet turke dhe nga Arabia të vihen pas tij këtë verë.

Miliardi Jeff Bezos, i interesuar për ta blerë klubin e NBA-së

Boston Celtics është në shitje pas titullit të 18 kampion të fituar pak muaj më parë. Kampioni i NBA-së është në kërkim të një pronari dhe në këtë garë ka hyrë fuqishëm Jeff Bezos. Për interesin e shfaqur nga pronari i “Amazon” ka treguar hollësi gazetari i njohur amerikan Bill Simmons i “The Ringer”. Vendimi i Wyc Grousbeck për ta shitur ekipin e Bostonit nuk pritej, por ky hap duket se nuk ka gjetur të papërgatitur shumë manjatë, të cilët kanë shprehur interesim për ekipin.

Gundogan rikthehet te City

Mesfushori Ilkay Gundogan do të rikthehet në Manchester City. Kjo gjë tashmë është e sigurt. Marrëveshja është arritur dhe mesfushori gjerman me prejardhje turke do ta nënshkruajë kontratën njëvjeçare me “Citizens” deri në qershor të vitit 2025. Lajmin e ka dhënë gazetari sportiv italian, njëherësh ekspert i transfereve, Fabrizio Romano. Gjuha e përbashkët është arritur pas bisedimeve pozitive në 48 orët e fundit. Trajneri Pep Guardiola ishte ai që e dha dritën e gjelbër për ta pasur prapë në dispozicion mesfushorin kreativ, i cili po largohet nga Barcelona pas vetëm një viti të kaluar në “Camp Nou”. Për mesfushorin me përvojë kampioni anglez nuk do të paguajë fare para, ndërsa Barça do të lehtësohet me largimin e tij pasi nuk do ta paguajë një rrogë të lartë dhe do t’i lirohet vendi për ta regjistruar Dani Olmon.

Joao Felix, lojtar i ri i Chelseat

Klubi anglez Chelsea e ka zyrtarizuar transferimin e Joao Felix nga skuadra e La Ligës, Atletico Madrid. Chelsea ra dakord për një tarifë prej rreth 45.5 milionë eurosh për 24-

vjeçarin me Atleticon dhe gjithashtu do të ketë një klauzolë shitjeje si pjesë e marrëveshjes. Felix ka nënshkruar një kontratë shtatëvjeçare me Chelsea,

ndërsa është vetë faqja zyrtare e Bluve që ka konfirmuar transferimin. “Chelsea është e kënaqur të njoftojë për nënshkrimin e përhershëm të Joao Felix nga Atletico Madrid”,

thuhet në njoftimin e Chelseat. Ndryshe, portugezi shënoi 4 gola në 20 ndeshje në qëndrimin e tij të mëparshëm në Chelsea dhe shpresoj se ai do t’i shtojë numrat pas këtij

transferimi. Ndryshe, Chelsea dhe Atletico Madridi më herët kanë konfirmuar edhe marrëveshjen për mesfushorin Conor Gallagher, i cili ka kaluar te spanjollët.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Company Bejta” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810253774 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Company Bejta" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810253774 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Company Bejta” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810253774 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Simtex” Sh.p.k. Kaçanik në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për thurjen e fijeve dhe prodhimin e tekstitit në Kaçanik i Vjetër, Kaçanik.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.10.2024 në ora 10:00 në objektin e komunës së Kaçanikut në sallën e kuvendit do të organizohet debat publik nga Kompania "Simtex" Sh.p.k. Kaçanik në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Simtex" Sh.p.k. Kaçanik për fabrikën përthurjen e fijeve dhe prodhimin e tekstilit në Kaçanik i Vjetër, Kaçanik.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bashkim Gegaj B.I. D.P.H “Bon-Ami” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 810255994.
- “Onfinio” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811478529.
- Valentina Sadiku shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm ekonomike “Hasan Prishtina”.
- Valentina Sadiku shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DIAKONIE TRAINING CENETR (DTC) me numër protokolli 406/18.
- “Cufa Construction” SH.P.K., shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811317602.
- Arlnida Sefa shpall të pavlefshme dëftesën e kl VI - IX Marif Skul Prizren.
- Arnel Redzepovic shpall të pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Elsa Krasniqi nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X-, të lëshuar nga shkolla “Ahmet Gashi. Prishtinë.
- Muhamed Pacolli shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “Eqrem Çabej”, Prishtinë.
- Trendelina Brahim Krasniqi nga Qifllaku i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e lëshuar nga shkollës e mesëm Teknike “11 maji”, Prizren, nga vitit 2000-2004.
- Armend Brahaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Varis Halce shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu “Marilo Goreci” Prizren.
- Shani Pervance shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Xhevdet Kokollari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Lekë Dukagjini” Prizren.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

